

**L I G J**  
**Nr.7929 datë 11.5.1995**

**PËR MBROJTJEN E DRUFRUTORËVE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e drufrutorëve nga dëmtimet mekanike, të qëllimshme ose jo, nga çdo subjekt fizik e juridik vendas a i huaj.

**KREU II**  
**PËRCAKTIME**

**Neni 2**

Në këtë ligj do të përdoren këto përcaktime:

“Sipërfaqe me drufrutorë” është toka bujqësore e mbjellë me pemë frutore, agrume, ullinj e vreshta që janë regjistruar si të tilla në kadastrë.

“Pemëtore” janë tokat e mbjella me pemë frutore dhe agrume që plotësojnë sipas specieve mbi 50 për qind të numrit minimal të bimëve për njësinë e sipërfaqes sipas projektit teknologjik.

“Ullishte” janë tokat e mbjella me ullinj që kanë mbi 50 për qind të numrit minimal të bimëve për njësinë e sipërfaqes.

“Vreshtat” janë tokat e mbjella me hardhi që kanë mbi 50 për qind të numrit minimal të bimëve për njësinë e sipërfaqes.

“Pemëtore e degraduar” janë pemishtet, ullishtet e vreshtat që për arsye moshe, mungesë shërbimesh ose faktorësh klimatikë e biologjikë, bimët janë dëmtuar rëndë dhe masat agroteknike të mundshme nuk mund të bëjnë ripërtëritjen e tyre, deri në nivelin e prodhimit të leverdishëm.

**KREU III**  
**FONDI I DRUFRUTORËVE DHE REGJISTRIMI I TYRE**

Fondi drufrutor përbëhet nga pemët frutore, hardhitë e vreshtave, agrumet dhe ullinjtë e mbjellë me blloqe ose të shpërndarë.

**Neni 4**

Inventarizimi dhe kadastrimi i drufrutorëve, si dhe ndryshimet e gjendjes së tyre, bëhen sipas rregullores së veçantë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

**KREU IV**  
**MBROJTJA E DRUFRUTORËVE**

**Neni 5**

Pemët frutore, vreshtat, agrumet dhe ullishtet, pavarësisht se në pronësi të kujt janë, janë pasuri kombëtare dhe mbrohen me ligj nga shteti.

#### Neni 6

Personat fizikë a juridikë, vendas a të huaj, në bashkëpunim ose jo ndërmjet tyre, të cilët kanë në pronësi a përdorim fond drufrutorësh në blloqe ose të shërndara, janë të detyruar të sigurojnë mbrojtjen e tyre nga prerjet ose dëmtime të tjera fizike.

#### Neni 7

Prerja e drufrutorëve dhe ndryshimi i destinacionit të tokës nga pemëtore në tokë arë, nga pronarët bëhet vetëm në këto raste:

1. Pemëtorja, për arsye fizike e biologjike, është e degraduar dhe investimet e mundshme për ripërtëritjen e saj do të jenë pa interes ekonomik për subjektin që e ka në pronësi.

2. Subjekti që e ka në pronësi pemëtoren për arsye ekonomike do të ndryshojë destinacionin e tokës nga pemëtore në tokë arë.

Në të dy rastet e mësipërme subjekti përkatës paraqet projekt rikonstruksioni dhe kërkohet miratimi nga organet kompetente të bujqësisë në rreth sipas nenit 8.

3. Bimët janë dëmtuar rëndë ose janë tharë si pasojë e faktorëve klimatikë, biologjikë a të moshës.

4. Në pemëtore janë parashikuar të ndërtohen objekte publike shtetërore ose private.

#### Neni 8

Prerja e drufrutorëve sipas pikave 1, 2, 3 e 4 të nenit 7 të këtij ligji bëhet vetëm me leje nga organet përkatëse të bujqësisë dhe konkretisht:

1. Për pemët sporadike dhe ato në pemishte, si dhe për vreshtin deri në 0.1 ha nga specialisti i degës së bujqësisë në komunë. Mbi 0.1 ha nga drejtoria e bujqësisë dhe e ushqimit në rreth. Përjashtim bën prerja e arrës, për çka të drejtën ekskluzive e ka Drejtoria e Bujqësisë dhe e Ushqimit në rreth.

2. Për ullinj të veçuar leja jepet nga drejtoria përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, me propozim të drejtorisë së bujqësisë në rreth.

3. Koleksionet e pemëve frutore, agrumeve, ullinjve dhe vreshtave, si dhe bimët e vetmuara që kanë vlera të veçanta gjenetike, priten vetëm me miratim të drejtorisë së prodhimit bimor në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit e të Institutit të Pemëtarisë e Vreshtave.

4. Për hardhitë e veçuara në tenda ose në ereke nuk kërkohet leje nga organet shtetërore.

#### Neni 9

Kriteret për verifikimet dhe për dhënien e lejes nga specialisti i degës i drejtorisë ose i ministrisë përcaktohen në rregulloren e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Për zbatimin e kriterëve të vlerësimit dhe të dhënies së lejes specialisti mban përgjegjësi, sipas rastit, disiplinore ose penale.

#### Neni 10

Çdo person juridik e fizik që ka në pronësi a përdorim një fond drufrutorësh, për të cilët kërkohet prerja e kushtëzuar sipas nenit 7 të këtij ligji, bën kërkesë me shkrim në degën e bujqësisë në komunë, që është e detyruar të dërgojë jo më vonë se 15 ditë specialistin për të verifikuar në vend dhe për të bërë veprimet përkatëse për lejimin ose moslejimin e prerjes.

#### Neni 11

##### **Vlerësimi i drufrutorëve**

Për efekt kompensimi të personave, kur drufrutorët priten për shkak se do të ndërtohen objekte

ndërtimore publike, dhe për dëmtimet me dashje ose nga pakujdesia përcaktohet vlera reale e tyre.

Kjo vlerë përcaktohet nga specialisti i degës së bujqësisë në komunë ose nga grupi i specialistëve të drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit në rreth. Kufijtë e kompetencave dhe kriteret e vlerësimit përcaktohen në rregulloren e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

#### Neni 12

Prerja e drufrutorëve në pemëtore, ullishte e vreshta, pasi është refuzuar më parë leja për prerjen e tyre nga organet kompetente, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë deri në 5-fishin e masës së dëmit, ose me heqje lirie gjer në 30 ditë.

Të drejtën e gjobës e kanë specialistët e degës së bujqësisë në komunë dhe të drejtorisë së bujqësisë në rreth, si dhe personat e tjerë të ngarkuar e të autorizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Procedura e shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative dhe ankimi kundër vendimit të dënimit bëhet sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

#### Neni 13

Kur drufrutorët dëmtohen me dashje ose nga pakujdesia dhe për nga përmasat dëmi përbën vepër penale, dëmtuesi dënohet sipas dispozitave të kodit penal.

#### Neni 14

Për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, organet e bujqësisë në rreth e komunë, kur është e nevojshme, kërkojnë ndihmën dhe mbështetjen nga organet e rendit publik a të zyrës së përmbarimit në rreth, të cilat janë të detyruara t’i mbështesin ato.

#### Neni 15

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit ngarkohet të nxjerrë në zbatim të këtij ligji, rregulloren përkatëse për mbrojtjen e drufrutorëve.

#### Neni 16

Aktet ligjore dhe nënligjore ekzistuese për mbrojtjen e drufrutorëve shfuqizohen.

#### Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.1102, datë 24.5.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha**